

**KONTRATË DHURIMI**  
**( Kuota Kapitali )**  
**Shoqëria “Firdeus Security Group” shpk**

Sot me date 07.12.2022 (dymije e njëzet e dy), palët përpiluan këtë kontratë dhurim kuotash si me poshte vijon:

**PALA DHURUESE: Taulant Demiraj** i biri i Baki-ut lindur më datë 20.08.1977 në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, pajisur me nr. Personal H70820172G.



**PALA PRANUESE: Iris Demiraj**, e bija e Bep, e datelindjes 02.09.1978 në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, pajisur me nr. Personal H85902045P.

Palët e mësipërme përpiluan këtë kontratë dhurim kuotash si me poshtë:

Në datë 09.11.2012 është regjistruar Shoqëria “**FIRDEUS SECURITY GROUP**” sh.p.k. me NIPT **L22309011R**, me seli në Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, pallati Alpas Center nr.1, Hyrja 1, Kati 3, me objekt të veprimtarisë së saj: “*Sherbime të ruajtjes së personave, objekteve dhe veprimtarive. Sigurimi i objekteve publike dhe private në pronësi ose në përdorim të personave fizike e juridike, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë; Sigurimi dhe mbrojtja e jetës dhe shëndetit të personave fizike, shtetas shqiptarë ose të huaj; Projektim, instalim i pajisjeve të vëzhgimit, sistemeve të alarmit dhe mjeteve të mbrojtjes kundër zjarrit; Import-Eksport të materialeve dhe pajisjeve në funksion të kësaj veprimtarie; Ofrimin e shërbimit të sistemeve të G.P.S-e (instalim, montim, mirëmbajtje dhe gjurmim) Nderime të ndryshme civile, ekonomike, industriale, turistike, bujqësore, rikonstruksione; Eksport/Import të shërbimeve të ndryshme, hidraulike, elektrike, informatike, konsulence në fushën e tregtisë, çdo lloj aktiviteti tregtar që shoqëria do të jetë në gjendje të ushtrojë; Ofrimi i shërbimeve për kompani të tjera, agjent mes kompanive të ndryshme, çdo lloj konsultimi, konsultime industriale; Aktivitetet në promovimin dhe zhvillimin e pasurive të paluajtshme në sektorin turistik-rezidencial, operacione tregtare, industriale, financiare, mobiliare dhe imobiliare, agjenci imobiliare, agjenci vlerësimi mjedisor; Import eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve televizive, filmike, mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, artikuj bujqësor dhe blegtoralë, pajisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, 2 konfeksione, metrazhe, detergjente pastrues, produkte kozmetike; Shoqëria mund të kryejë çdo lloj shërbimi që paraqitet në pajtueshmëri me objektin e saj dhe që është e lidhur me këtë objekt duke përjashtuar ato shërbime apo veprimtari që do të shkaktonin devijimin e saj nga karakteri plotësisht i percaktuar në ligje të vecanta; Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivit të saj duke përfshirë edhe veprime për shitblerje sendesh të luajtshme e të paluajtshme, pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndermarrje të tjera”, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, sot (QKB) me NIPT **L22309011R** me status aktiv dhe me kapital themeltar 100.000 (njëqind mijë) lekë, të ndara në 100 kuota (pjesë).*

Shoqëria “**FIRDEUS SECURITY GROUP**” sh.p.k perbehet nga 2 (dy) Ortakë:

1. z. Taulant Demiraj i cili zotëron 50 % (pesëdhjetë) kuota të kapitalit themeltar 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50 (pesëdhjetë) pjesë, me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secila pjesë, të barabarta me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. z. Renaldo Çulli i cili zotëron 50 % (pesëdhjetë) kuota të kapitalit themeltar 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50 (pesëdhjetë) pjesë, me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secila pjesë, të barabarta me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.





Me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë **FIRDEUS SECURITY GROUP** sh.p.k ne datë 07.12.2022, është vendosur :

Ortaku i Shoqërisë **FIRDEUS SECURITY GROUP** sh.p.k z. Taulant Demiraj i cili zotëron 50 % (pesëdhjetë) kuota të kapitalit themeltar 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50 (pesëdhjetë) pjesë, me vlerë nominale 1000 (nje mije) lekë secila pjesë, të barabarta me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, i'a dhuron znj. Iris Demiraj, 50 % (pesëdhjetë) kuota të kapitalit themeltar 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50 (pesëdhjetë) pjesë, me vlerë nominale 1000 (nje mije) lekë secila pjesë, të barabarta me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Perfundimisht Ortakë të Shoqërisë **FIRDEUS SECURITY GROUP** sh.p.k bëhen znj.Iris Demiraj dhe z. Renaldo Çulli, të cilit bëhën zoterues 100 % te kuotave te kapitalit themeltar, ose të ndara respektivisht :

1. znj. Iris Demiraj e cila zotëron 50 % (pesëdhjetë) kuota të kapitalit themeltar 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50 (pesëdhjetë) pjesë, me vlerë nominale 1000 (nje mije) lekë secila pjesë, të barabarta me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. z. Renaldo Çulli i cili zotëron 50 % (pesëdhjetë) kuota të kapitalit themeltar 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50 (pesëdhjetë) pjesë, me vlerë nominale 1000 (nje mije) lekë secila pjesë, të barabarta me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Pranuesja znj. Iris Demiraj deklaron se është dakort të pranojnë 50 % (pesëdhjetë) kuota të kapitalit themeltar 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ose 50 (pesëdhjetë) pjesë, me vlerë nominale 1000 (nje mije) lekë secila pjesë, të barabarta me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, nga dhuruesi z. Taulant Demiraj, **pa shpërblim.**

Palët ranë dakort se me nënshkrimin e kontratës dhe regjistrimin e kontratës së dhurimit të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë **FIRDEUS SECURITY GROUP** SH.P.K, në Qëndren Kombëtare të Biznesit, Ortakë të Vetëm të Shoqërisë "**FIRDEUS SECURITY GROUP**" SH.P.K bëhen znj. Iris Demiraj dhe z. Renaldo Çulli.


Pala dhuruese deklaron se do të jetë përgjegjëse për të gjitha detyrimet që do të lindin përpara lidhjes së kontratës së mësipërme me persona fizik, juridik përfshi këtu dhe shtetin, ndërsa për detyrimet që do të rrjedhin pas lidhjes së kontratës përgjegjëse do te jetë pala pranuese.

Kjo Kontratë Dhurim Kuotash përpilohet ne baze te nenit 761 e vijues te Kodit Civil, ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar.

Kontrata u përpilua në 3 (tre) kopje të njëjta, i'u lexua palevë me zë të lartë dhe të qartë, u kuptua prej tyre dhe meqënëse u gjet sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë nënshkruhet rregullisht sipas ligjit.

**PALA DHURUESE**

Taulant Demiraj



Page 2 of 2

**PALA PRANUESE**

Iris Demiraj

